



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:230831

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06708182

P.nr.933/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.I, me vendbanim në fshatin, Komuna e Deçanit, i akuzuar për veprën penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.1878/2023, të datës 27.10.2023, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik të datës 06.01.2025, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit M.I, dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av.Blerim Ademaj, nga Peja, me datën 09.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

M.I, i atësisë I. dhe amësisë T., e vajzërisë, i lindur me datë në Pejë, me vendbanim në fsh., rr. “.....”, nr., K. Deçan, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal i lëshuar nga MPB, Republika e Kosovës, posedon numër të tel. dhe, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet nën masën e paraburgimit për një veprë tjetër penale.**

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 20.09.2023 në ora 17:30 min, në rr. “.....”, Komunës së Pejës, pa autorizim, ka poseduar substanca narkotike të llojit “Marihuanë”, në atë mënyrë që përderisa zyrtaret policor gjatë punës hetimore lidhur me një rast të vjedhjes së rëndë e arrestojnë të pandehurin, gjatë kontrollit të tij në xhepin e tij kanë gjetur dhe sekuestruar një qese plasmasi me substancë

narkotike të llojit marihuana, e cila substancë narkotike sipas pajisjes NarTest NTX2000 ka rezultuar që është e llojit marihuanë me peshë neto 20.09 gram,

- Me çka ka kryer veprën penale "**Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge**" nga neni 269 parag. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 dhe 269 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME GJOBË**, në shumë prej pesëqind (500) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Si dhe me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditësh, e i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e cekur si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do të e zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro, gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20) euro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V. Konform nenit 269 par.3, të KPRK-së, **KONFISKOHET** - substanca narkotike e llojit marihuanë, në peshën neto 20.9 gram të sekuestruara përkohësisht, dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohet që të shkatërrohen.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.10.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1878/2023, ndaj të pandehurit M.I, për shkak të veprës penale "**Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge**" nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare me datë 06.01.2025, e cila u mbajt në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit M.I si dhe mbrojtësit të të pandehurit M.I, av. Blerim Ademaj nga Peja, i caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP/II.nr.1878/2023, të datës 27.10.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri M.I, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me ç'rast i njëjti me vullnet e vetëdije të plotë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ndihet i penduar dhe premtos se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Andaj, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç'rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Më pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit të lartcekur është pajtuar edhe mbrojtësi i të pandehurit M.I, av. Blerim Ademaj i cili ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim, i njëjti është bere në konsultim të mjaftueshëm me mua si mbrojtës dhe kërkoj nga gjykata qe ti aprovohet.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, e që pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-PE-75 i datës 20.09.2023; raporti i oficerit H.N #5292 i datës 20.09.2023; raporti i hetuesit N.Z #8397 i datës 20.09.2023; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 20.09.2023; fotografi nga vendi i ngjarjes dhe të substancave narkotike, raporti i analizës së narkotikut i datës 22.09.2023.*

Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *sa i përketë rrethanave rënduese i propozoj gjykatës të marr parasysh ndonjë dënim të mëparshëm eventual ndaj të pandehurit ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë për veprën e kryer penale.*

Mbrojtësi i të pandehurit M.I, av. Blerim Ademaj, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të mirët pranimi i fajësisë, pendimi dhe keqardhja e tij për veprën penale të cilën e ka kryer, dhe i propozoj gjykatës që ndaj të mbrojturit tim të shqiptohet një dënim nën minimumin e paraparë me ligj.*

I pandehuri M.I, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që e kam kryer, që nga ajo ditë nuk kam përdorur substanca narkotike, i kërkoj falje gjykatës, tash jam i pastër dhe nuk jam përdorues i substancave.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Gjyqtarja e vetme gjykuese në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana posaçërisht lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë, shprehjen e pendimit për veprën penale të cilën e ka kryer dhe premtimin që i njëjti në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, ndërkaq rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata mori parasysh faktin ku në bazë të dhënave penale të lëshuara nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës, vërtetohet së i njëjti ka qenë edhe më herët i dënuar për vepra tjera penale dhe atë sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.242/22, të datës 16.12.2023, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 07.02.2024, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, me dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) Euro si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, të cilat dënime kushtëzohen dhe nuk do të ekzekutohen nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej dy (2) viteve, po ashtu i njëjti është dënuar edhe sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda, nën shenjën P.nr.184/2014, të datës 04.06.2014, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 04.03.2016, për shkak

të dymbëdhjetë (12) veprave penale “*Vjedhja grabitqare*” nga neni 254 paragrafi 1 të KPK-së, me dënim unik me burgim prej katër (4) vite. Poashtu sa i përket sjelljeve dhe personalitetit të pandehurit në të kaluarën gjykata ka gjetur se i njëjti është i dënuar edhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Pejës-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.1048/22 të datës 07.11.2024, i cili është i dënuar me dënim me burgim me gjobë në shumën prej 700 euro, për veprën penale “*Posedim i paautorizuar i narkotikëve apo substancave psikotrope apo analoge*”, nga neni 269 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Pejës-Departamentit të Përgjithshëm, nën shenjën P.nr.253/24, të datës 10.01.2025, përmes të cilit i pandehuri është dënuar me dënim me burgim efektiv në kohëzgjatje prej 120 ditësh, për veprën penale “*Sulmi*” nga neni 181 par.1 i KPRK-së, mirëpo këto aktgjykime nuk e mori në vlerësim në kundërt të rrethanave rënduese pasi që të njëjtat ende nuk figurojnë të jetë bërë të plotfuqishme.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me burgim gjykata e mori duke u bazuar në nenin 269 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin e lidhur me nenin 42 dhe 43 të KPRK-së.

Sipas nenit 269 par.1 të KPRK-së, dënueshmëria për këtë veprë penale sipas ligjvënësit është përcaktuar me: “*Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet*”, andaj gjykata për të njëjtin ka shqiptuar dënim me gjobë konform nenit 43 të KPRK-së, si dhe dënim me burgim sipas nenin 42 të KPRK-së. Përcaktimi i dënimit me burgim për të pandehurin M.I, me dënim me burgim prej 90 ditësh, u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikënisje e dënimit për veprën penale “*Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga nenin 269 par.1 të KPRK-së, është dënimi prej 2 vitesh. Pastaj, duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke zbatuar nenin 71 pika 1.3 të KPRK-së i cili përcakton se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “*në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë*” dhe nenin 72 par.1 pika 1.5 të KPRK-së, i cili përcakton se: “*nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim*”, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në

të gjitha fazat e procedurës penale për veprën penale në fjalë, andaj mbi këtë fakt gjykata pranimin e fajësisë e mori si bazë për zbutjen e dënimit.

Zbutja e dënimit u bë në kuadër të mundësive të përcaktuara më ligj, pasi që neni 76 par.1 pika 1.3 ka paraparë *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku tre (3) vjet, dënimi mund të zbutet deri në një (1) vit burgim”*.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform neni 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi si në pikën e VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të neni 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform neni 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke u bazuar në dispozitat e neni 269 par. 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 269 par.3, të KPRK-së, me ç’rast, 20.9 gram substancë narkotike e llojit marihuanë, të sekuestruara me vërtetimin për sekuestrim të përkohshëm të datës 22.09.2023, janë konfiskuar dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, do të bëhet shkatërrimi i saj.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të neni 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.933/23, me datë 14.01.2025.

Zyrtarja ligjore
Blerinda Laiq

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.